

VENDIM
Nr. 353, datë 19.4.2017

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE KONTRAKTORE PËR TË NDËRMARRË E ZHVILLUAR PROCEDURAT PËR DHËNIEN ME KONCESION/ PARTNERITET PUBLIK PRIVAT, TË PROJEKTIT ME OBJEKT “PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURAVE ARSIMORE NË BASHKINË E TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të Bashkisë Tiranë si autoritete kontraktore për të ndërmarrë e zhvilluar procedurat për dhënie me koncesion/partneritet publik privat të projektit për përmirësimin e infrastrukturave arsimore në Bashkinë e Tiranës.
2. Ngarkohet Bashkia Tiranë të administrojë procedurat për dhënie me koncesion/PPP, në përputhje me ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, të projektit me objekt “Përmirësimi i infrastrukturave arsimore në Bashkinë e Tiranës”.
3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi